



Human Rights Review Panel

## **Buletini informativ nr. 18 – 01 nëntor – 30 qershor 2018**

- Seancat e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Vizita e praktikantëve të EULEX-it në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Dorëheqja e anëtarëve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Dorëheqja e zyrtares ligjore, znj. Joanna Marszalik
- Ndikimi i rikonfigurimit të personelit të EULEX-it në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Publikimi i raportit vjetor 2017 nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Numri i lëndëve
- Statistika e lëndëve
- Seanca e radhës e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### **Seancat e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**

#### **Seanca e 36-të e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, e mbajtur nga data 4 deri më 6 dhjetor 2017**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 36-të nga data 4 deri më 6 dhjetor 2017, ku ndër të tjera ka shqyrtuar njëzet e një (21) lëndë.

Lënda nr.: [2011-27 F dhe të Tjerët kundër EULEX-it](#) ishte parashtruar më 14 nëntor 2011 nga familja e X.F., e cila kishte qenë dëshmitare e prokurorisë në një rast penal të rëndë. Pas disa atentatesh nga persona të panjohur ndaj tij, X.F., F. dhe fëmijët e tyre ishin pranuar në Programin e Sigurisë së dëshmitarëve të EULEX-it (PSD). Ata kanë vërejtur se kushtet e tyre ishin shumë të vështira në PSD dhe kanë dalë nga programi vullnetarisht. Sidoqoftë, pasi që X. F. akoma dëshironte të dëshmonte në lidhje me këtë rast, ai ishte bartur në një shtet anëtar të BE-së. X.F. ishte kthye në Kosovë për të dhënë deklarata në seancën para-gjyqësore në lidhje me rastin. Ai ishte pranua rishtas në PSD. Pak kohë më pas ai ishte kthye në shtetin anëtar të BE-së, ku vdiq më 28 shtator 2011. Një hetim i kryer nga policia anëtare e BE-së, kishte vërtetuar se ai kishte kryer vetëvrasje. Ankuesit kanë parashtruar se presioni psikologjik që i ishte nënshtruar X.F.-së, trajtimi i tij nga EULEX-i, si dhe izolimi i tij nga familja e tij, e detyruan atë të bënte vetëvrasje. Ata pohuan se EULEX-i ishte në dijeni rreth gjendjes

së brishtë mendore të X.F.-së, por nuk kishte arritur të ndërmerre hapat e nevojshëm për të parandaluar vdekjen e tij.

Paneli ka konstatuar që veprimet apo mosveprimet e fajshme të EULEX-it kishin të bënin jashtëzakonisht shumë me gjendjen e përgjithshme të mirëqenies së X.F.-së dhe familjes së tij. Prandaj Paneli nuk është bindur që EULEX-i i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme sigurisë dhe mbrojtjes së tyre. Prandaj, Paneli konsideron se kishte pasur shkelje të pjesës procedurale të nenit 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj-së), si dhe shkelje të nenit 3 të KEDNj-së për aq sa e ka ndaluar trajtimin çnjerëzor ose poshtërues. Paneli ka rekomanduar që shefi i Misionit të bënte një deklaratë, ku do të pranonte se rrethanat e rastit përbënin shkelje të të drejtave të ankuesve që i atribuohen veprimeve dhe lëshimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv dhe se ajo duhet të shpërndajë vendimin tek stafi përkatës i EULEX-it në mënyrë që ata të kenë udhëzimet e nevojshme lidhur me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut në çështje të tilla.

Paneli ka publikuar versionin e redaktuar të vendimit të tij në lëndën nr. [2011-27 F dhe të Tjerët kundër EULEX-it](#) në bazë të një kërkesë nga shefi i Misionit për ta bërë këtë në përputhje me kompetencat e dhëna mbi të nga dispozitat përkatëse të aneksit 12/D11 i OPLAN-it, (Shtojca 10/D11 sipas OPLAN-it të ri).

Paneli gjithashtu ka komunikuar deklaratat e fakteve dhe pyetjeve tek shefi i Misionit në lidhje me njëzet (20) raste të personave të vrarë dhe të zhdukur (lënda nr. 2016-09 deri 2016-23 dhe lëndët nr. 2016-28 deri 2016-32).



Nga e majta në të djathtë: Magda Mierzevska, John J Ryan, Guenael Mettraux dhe Anna Bednarek gjatë seancës së 36 të Panelit

### **Seanca e 37-të e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, e mbajtur nga data 10 deri më 12 prill 2018**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur seancën e 37-të nga data 10 deri më 12 prill 2018. Paneli ka lëshuar tre vendime të papranueshmërisë dhe i ka komunikuar një lëndë shifes së Misionit të EULEX-it për vërejtje.

Dy lëndë kanë të bëjnë me procedurat pranë gjykatave të Kosovës ([R.I. kundër EULEX-it, nr. 2016-34](#) dhe [Ndërmarrja Hoteliere Turistike Iliria Deçan kundër EULEX-it, nr. 2016-35](#)). Si në shumë raste të ngjashme të mëparshme, Paneli ka deklaruar se nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës, edhe nëse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues.

Ankesa e tretë ([A.Z. kundër EULEX-it, nr. 2017-01](#)) ka të bëjë me vendimin e prokurorëve të EULEX-it që të mos hetonin rastin e ankuesit. Paneli ka konstatuar se ajo çështja penale në mënyrë të qartë nuk binte nën autoritetin e prokurorëve të EULEX-it sipas Ligjit mbi Juridiksionin. Rrjedhimisht, ankesa ishte e pabazuar. Për më tepër, Paneli ka konstatuar se veprimi rreth të cilës është bërë ankesa ka hyrë jashtë afatit kohor gjashtë mujor për dorëzimin e ankesës.

Paneli ka shqyrtuar një lëndë që kishte të bënte me fatin e një personi që dyshohej se ishte zhdukur që nga viti 1998. Ankesa ishte parashtruar nga anëtarë i familjes së tij. Paneli i ka komunikuar lëndën shifes së Misionit të EULEX-it, duke kërkuar vërejtjet e saj mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës.

Gjatë seancës, Paneli gjithashtu ka vizituar Institutin e Mjekësisë Ligjore të EULEX-it, ku zëvendës shefi i Departamentit të EULEX-it për Mjekësinë Ligjore ka dhënë një prezantim mbi punën e këtij instituti.

### **Seanca e 38-të e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, e mbajtur më 24 dhe 26 maj 2018**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 38-të nga data 24 maj deri më 26 maj 2018, ku ndër të tjera ka nxjerrë tre vendime të papranueshmërisë.

Lënda e parë e [Hysni Gashit kundër EULEX-it, lënda nr. 2017-05](#) lidhur me vrasjen e dy personave dhe tentim vrasjen ndaj disa personave të tjerë në tarracën e një kafeneje në komunën e Shtimes më 22 prill 2006. Paneli më parë e kishte trajtuar një pjesë të kësaj ankese në lëndën nr. [2011-22](#), ku kishte nxjerrë një vendim të papranueshmërisë, siç ishte kërkuar nga ankuesi sipas nenit 6, të Ligjit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli ka konstatuar se ankuesi kishte dështuar të përcaktonte ndonjë arsye për rishqyrtimin e vendimit të mëparshëm në pajtim me rregullën 43 (3) të Rregullores së Punës (RrP) në atë që Paneli mund të refuzojë kërkesën për rishikimin e gjetjeve të tij nëse nuk ekziston asnjë arsye për të arsyetuar rishqyrtimin e tyre. Paneli gjithashtu ka gjetur që pjesa e mbetur e ankesës ishte qartazi e pabazuar në kuptim të nenit 29 (1) (e) të RrP-së dhe se gjithashtu nuk ka zbatuar nenin 25 (3) të RrP-së në lidhje me përfilljen e afatit të caktuar për paraqitjen e ankesave të tilla.

Faktet e lëndës së dytë, [Feriz Gashi kundër EULEX-it, lënda nr. 2017-06](#) ishin të ngjashme me faktet e lartpërmendura në lëndën e Hysni Gashit kundër EULEX-it, lënda nr. 2017-05. Paneli ka konstatuar se pjesa e parë e ankesës në thelb ishte e njëjtë me atë që tashmë ishte shqyrtuar, në kuptim të Rregullës 29 (1) (a) të RrP-së dhe ankuesi nuk kishte arritur të përcaktonte ndonjë arsye që të rishqyrtohej vendimi, në përputhje me rregullën 43(3), siç është përshkruar më sipër. Paneli ka konstatuar se pjesa e mbetur e ankesës ishte qartazi e pabazuar në kuptim të nenit 29 (1) (e) të RrP-së dhe se ankesa nuk kishte zbatuar nenin 25(3) të RrP-së në lidhje me afatin për paraqitjen e ankesave.

Lënda e tretë, [C.X kundër EULEX-it, lënda nr. 2017-07](#), kishte të bënte me pjesëmarrjen e ankuesit dhe të tjerëve në një grup të kimit të organizuar në lidhje me kontrabandimin e migrantëve. Paneli ka konstatuar se i mungonte kompetenca për të shqyrtuar ankesën, pasi ajo ka hyrë jashtë juridiksionit të tij në kuptim të nenit 29 (d) të RrP-së të saj dhe se nuk kishte zbatuar nenin 25(3) të RrP-së në lidhje me afatin për paraqitjen e ankesës.



Nga e majta në të djathtë: John J Ryan, Joanna Marszalik, Guenael Mettraux dhe Anna Bednarek gjatë seancës së 38-të të Panelit

### **Vizitë e praktikantëve të EULEX-it në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**

Dymbëdhjetë (12) praktikantë të rinj të EULEX-it kanë vizituar PShDNj-në më 6 mars 2018. Praktikantëve iu ofrua një prezantim i hollësishëm mbi mandatin, procedurat dhe funksionimin e Panelit. Prezantimi u pasua me pyetje, përgjigje dhe diskutime.



Grupi i ri i praktikantëve të EULEX-it, nga e majta në të djathtë: John J Ryan, Kushtrim Xhaferi dhe Valentina Vitali

### **Dorëheqja e anëtarëve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**

Anna Bednarek, anëtare nga EULEX-i e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka dhënë dorëheqje nga Paneli më 14 qershor 2018. Znj. Bednarek gjithashtu ka mbajtur pozitën e saj parësore si gjykatëse ndërkombëtare e apelit në Kolegjin e Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës. Znj. Bednarek ka shërbyer në mënyrë të konsiderueshme si anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it. Dorëheqja e saj nga Paneli erdhi si rezultat i rikonfigurimit të stafit të EULEX-it së bashku me përfundimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it më 14 qershor 2018.

Ngjashëm, z. Jorge Ribero ka dhënë dorëheqjen nga Paneli si anëtar zëvendësues i EULEX-it më 14 qershor 2018, pas një kohë të shkurtë me Panelin. Z. Ribero njëkohësisht ka mbajtur postin kryesor si gjykatës penal në Gjykatën Supreme të Kosovës/Gjykata e Apelit. Dorëheqja e tij nga Paneli ishte gjithashtu e domosdoshme pas rikonfigurimit të EULEX-it dhe përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it më 14 qershor 2018.

### **Dorëheqja e zyrtares ligjore, znj. Joanna Marszalik**

Znj. Joanna Marszalik, zyrtare ligjore e Panelit ka dhënë dorëheqje më 30 qershor 2018. Ajo ka shërbyer zyrtare ligjore në Panel nga muaji prill 2012 deri më 15 tetor 2016 dhe përsëri nga data 29 janar 2018 deri më 15 qershor 2018.

### **Ndikimi i rikonfigurimit të stafit të EULEX-it në Sekretariatit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**

Numri i zyrtarëve ligjor të Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ishte reduktuar nga dy (2) zyrtarë ligjor në një (1) zyrtar ligjor pas rikonfigurimit të fundit të stafit të EULEX-it. Reduktimi i numrit të zyrtarëve ligjor nga tre (3) zyrtarë ligjor në dy (2) zyrtarë ligjor me rikonfigurimin e fundit të stafit të EULEX-it në vitin 2016, përbën një reduktim përafërsisht 66% të personelit të zyrtarëve ligjor të Sekretariatit gjatë dy (2) viteve të fundit. Ndikimi negativ i këtij reduktimi të numrit të zyrtarëve ligjor në punën e Panelit është mjaft i papërshtatshëm, e poashtu duke pasur parasysh faktin se ngarkesa e punës së Panelit ka mbetur konstante gjatë gjithë kohës, me njëzet e pesë (25) lëndë që aktualisht janë ende duke u trajtuar në Panel.

Edhe pse roli i Panelit është i lidhur me kohëzgjatjen e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë, Paneli mund të veprojë për një periudhë shtesë të kufizuar pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë, si i nevojshëm për shqyrtimin e ankesave ekzistuese ose ankesave që mund të parashtrihen brenda afatit gjashtë (6) mujor pas skadimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it, d.m.th. 14 dhjetor 2018. Paneli do të përfundojë gjithashtu raportin e përfundimit të misionit brenda kësaj periudhe plotësuese.

### **Publikimi i Raportit vjetor 2017 të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**


Raporti vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut për periudhën 1 janar 2017 deri më 31 dhjetor 2017 është publikuar më 1 qershor 2018. Raporti mund të shkarkohet në: <http://www.hrrp.eu/alb/annual-report.php>.

### **Statistika e lëndëve**

Aktualisht në Panel janë (25) ankesa në pritje.

## Statistika e lëndëve

Paneli ka shqyrtuar njëqind e shtatëdhjetë e një (171) lëndë që nga fillimi i veprimtarisë së vet në qershor të vitit 2010. Ai vlerësoi se EULEX-i Kosovë ka bërë shkelje të të drejtave në njëzet e pesë (25) raste. Gjithashtu, ka gjetur se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në njëzet e pesë (25) raste të tjera që Paneli i kishte konsideruar të pranueshme. Dy (2) ankesa janë parashtruar në Panel që nga 1 janari 2018 dhe aktualisht janë njëzet e pesë (25) raste të pazgjidhura në Panel.



## Publikimi i vendimeve

Të gjitha vendimet e Panelit janë publikuar në faqen e internetit të Panelit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe dhe gjendet në: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu).

## Seanca e radhës së Panelit

Ende nuk është caktuar data e mbajtjes së seancës së radhës së Panelit.

Vizitoni faqen tonë të internetit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)



## SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PSHDNJ

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

### Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

### Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk i shqyrton procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

### Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

### Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet në letër, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

### Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:



#### Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 28 2207

**Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës**

**elektronike në: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)**

**[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)**

Nëse ankesa parashtrohet përmes postës elektronike, atëherë ankesa origjinale e nënshkruar duhet të dorëzohet brenda katër javëve nga data e dërgimit të postës elektronike.

### Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter. Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit. Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.